



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Datë: 04/04/2025

Ref: 241/2025

E nderuar familje Xhepa,

Më lejoni t'ju shpreh ngushëllimet më të thella për humbjen e më të dashurës tuaj që është e dashur dhe e admiruar nga tërë kombi shqiptar.

Tani që aktorja e madhe nuk është mes nesh, t'i them ikonë më duket mbiemër i vogël. Emri i saj - Margarita Xhepa - është më shumë sesa çdo mbiemër me të cilin duam t'ia njohim lartësimin.

Para se të merrte rolin e fundit, atë të përjetësisë, e kishte përjetësuar teatrin dhe kinemanë shqiptare.

Shkëlqimi i saj skenik ka nderuar dhe ka mbajtur të bashkuar një komb.

Mirënjohja e falënderimi janë të pafundme për pasurimin e artit shqiptar dhe vetë historisë sonë.

Sinqerisht,

Albin Kurti

Kryeministër i Republikës së Kosovës